



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Puniljen/Produato Received/Delivery	28 - 06 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSARK	3780/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.05/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1949/21 të datës 09.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.05/2019 të datës 08.01.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në

Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.05/2019 e datës 08.01.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.KZKA-19/2018 i datës 17.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 08.01.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 36/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. KZKA-19/2018 të datës 17.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) më datë 11.01.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor, ndërsa Këshilli me datë 18.01.2019, ka pranuar dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.03.2019 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës me numër A.nr.05/2019 të datës 08.01.2019, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë gjyqësore në gjykatën kompetent gjegjësisht Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi përmes përfaqësueses me autorizim avokates serish me datë 02.06.2021 parashtron ri-ankesë me objekt të njëjtë ankimor, e cila i është bashkuar ankesës së datës 08.01.2019. Po me datë 09.08.2021 përfaqësuesja me autorizim e ankuesit kërkon sqarim lidhur me ankesën e datës 08.01.2019 dhe 02.06.2021, me ç' rast Këshilli me datë 09.08.2021 në përgjigje të kërkesës ka njoftuar ankuesin se në mungesë të anëtareve të Këshillit nuk ka mundur të shqyrtoj ankesën e ankuesit.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.1949/21 të datës 09.06.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit të datës 27.08.2021 duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 09.08.2021 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda 30 ditësh të vendos për ri-ankesën e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 36/2019 të datës 08.01.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 22.11.2018 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Vendimin me Nr.KZKA-19/2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Vendimin e Këshillit A.Nr.456/2018 të datës 11.09.2018; Autorizimin për publikimin e konkursit datë 01.10.2018 e lëshuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, Konkursin e datës 04.10.2018; Formularin Form.MAP-SHCK-01 për kërkesën për fillimin e rekrutimit (punësimin); Vendimin me Nr.prot 5548 i datës 25.09.2018; Vendimi i Këshillit A.nr.456/2018 i datës 11.09.2018; Formularin Form.MAP-SHCK-04 për Regjistrin e Aplikacioneve të pranuar; Kërkesën për punësim e kandidatës e datës 15.10.2018; Diplomën me Nr. 5268 e datës 08.01.1986; CV-në; Certifikatë Lindje e datës 21.12.2012; Certifikatë Shtetësie e datës 18.12.2012; Pasqyra e llogarisë nga Trusti; Kontratë për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 04.02.2019; Njoftim dhe kërkesë e datës 31.01.2019 dhe 24.10.2018; Marrëveshje për shërbime speciale e datës 03.01.2018; Kontratë me marrëveshje të veçantë të shërbimit e datës 04.11.2018, 04.06.2018; Kërkesa për punësim e kandidatit e datës 16.10.2018; Marrëveshje për shërbime speciale e datë 10.04.2015, 03.11.2015, 06.05.2016, 07.11.2016, 08.01.2017, 26.05.2017, 26.10.2017, 16.03.2018, 19.06.2018; Referencë e datës 09.02.2018; Vendimi me Nr.prot. 6140-2/18 i datës 23.10.2018; Vendimin me Nr. prot. 6117/18 i datës 22.10.2018; Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 23.10.2018 për kandidaten Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 23.10.2018 për ankuesin; Raportin mbi selektimin e kandidatëve i datës 23.10.2018; Njoftimin përmes e-mailit i datës 26.10.2018 për përfshirje në listën e shkurtër dhe testin me shkrim; Formularin Form.MAP-SHCK-06 për njoftimin e kandidatëve për testim nga

përzgjedhja e ngushtë; Testi me shkrim i datës 29.10.2018; Formularin Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin Form.MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe; Formularin Form.MAP-SHCK-11 i Raportit Final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 05.11.2018; Formularin Form.MAP-SHCK-10 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin Form.MAP-SHCK-09 për përmbledhje e vlerësimeve individuale; Njoftimin përmes e-mailit i datës 07.11.2018 për njoftimin e rezultateve përfundimtare; Njoftimi për përfundimin e procedurës së rekrutimit dhe rezultatin e testimi; Vendimi me Nr.Prot 6443/18 i datës 07.11.2018; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 07.11.2018; Aktgjykimin A.nr.1949/21 të datës 09.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ri-ankesën e datës 02.06.2021, emalin e datës 09.08.2021 nga përfaqësuesja me autorizim avokatja drejtuar Këshillit, emalin e datës 09.08.2021 nga Këshilli drejtuar F.H.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës rrjedhë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas Autorizimit të datës 01.10.2018 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil/MAP, me datë 04.10.2018 ka shpall Konkursin e Jashtëm me numër reference MMPH-22/2018 për pozitën e punës "Zyrtar/e Administrativ" në Sektorin për Mbrojtjen e Monumenteve të Natyrës me Rendësi të Veçantë në kuadër të Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Me tej nga shkresat e lëndës rezultojnë se në Konkursin me numër reference MMPH-22/2018 të datës 04.10.2018, kanë aplikuar gjithsej dymbëdhjetë (12) kandidatë, duke vazhduar me listën e ngushtë të datës 23.10.2018 me njëmbëdhjetë (11) kandidatë. Ankuesi ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procesit rekrutues, por që bazuar në Raportin Final të Komisionit Rekrutues të datës 05.11.2018 si kandidat i suksesshëm për pozitën e shpallur është vlerësuar kandidatja me gjithsej 432.5 pikë, ku dhe me Njoftimin e datës 07.11.2018 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kandidatja është shpallur si kandidatja me suksesshëm me gjithsej 86.5% pikë.

Ankuesi i pa kënaqur më mos përzgjedhjen e tij, më datë 22.11.2018 ka parashtruar ankesë pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa ky i fundit me Vendimin me Nr.KZKA-19/2018 të datës 17.12.2018 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.KZKA-19/2018 të datës 17.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më datë 08.01.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 36/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke shtuar se kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet sipas konkursit të datës 07.11.2018 dhe se Komisioni rekrutues nuk ka qenë profesional, vendimi për themelimin e këtij komisioni është në kundërshtim më nenin 7 paragrafi 1 dhe 5 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civil dhe së i njëjti nuk ka bërë

vlerësim të drejtë dhe të ligjshëm të dokumentacionit pasi që ankuesi ka plotësuar të gjitha kriteret për pozitën e punës Zyrtar administrativ. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, të ndryshoj vendimin e kontestuar me ankesë si dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e konkursit, ka konstatuar që në bazë të konkursit të shpallur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me numër reference MMPH-22/2018 të datës 04.10.2018 për pozitën e punës "Zyrtar/e Administrativ", kriteret të përcaktuar për këtë pozitë kanë qenë: -Diplomë Universitare në Ekonomi, Menaxhment, Menaxhim në Turizëm si dhe të ngjashme, apo Diploma e Shkollës së Lartë nga fushat e lartpërmendura; - Njohuri profesionale në fushën përkatëse të punës, të cilat janë fituar përmes fakultetit pa përvojë pune ose shkollës së lartë me dy (2) vite përvojë pune, rrjedhimisht nga analizimi i aplikacionit si dhe dëshmime të bashkangjitura nga kandidatja e përzgjedhur, Kolegji ka konstatuar se e njëjta sipas Diplomës me Nr.5268 të datës 08.01.1986 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, ka përfunduar Fakultetin Ekonomik duke marrë titullin "Ekonomist i Diplomuar", ndërsa përkitazi me përvojën e punës përkundër që ankuesja ka plotësuar kriterin e arsimit dhe të përvojës pasi që posedon diplomë universitare, Kolegji nga dëshmitë e ofruara nga ankuesja vëren se e njëjta posedon edhe përvojë pune në institucionet e administratës publike, andaj mbi këtë bazë konstatimi rrjedhë së është i pabazuar pretendimi ankimor në kuptimin së kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kriteret për pozitën e punës Zyrtar/e Administrativ sipas Konkursit me numër reference MMPH-22/2018 të datës 04.10.2018.

Po ashtu, Kolegji nga vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit të ankuesit ka vërtetuar së i njëjti sipas Diplomës me Nr.1307/14 të datës 11.10.2014 të lëshuar nga Kolegji AAB me datë 23.04.2014 ka përfunduar studimet "Banka, Financa dhe Kontabilitet" dhe së posedon edhe përvojë pune në institucionet publike, kështu që mbi këtë bazë rrjedhë së Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankuesit dhe kandidates së përzgjedhur duke vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1.arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë.* Mirëpo, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të vlerësimit përfundimtar të Komisionit Përzgjedhës ka gjetur së kandidatja e përzgjedhur është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë gjithsej 432.5 apo 86.5% të pikëve, ndërsa ankuesi është vlerësuar si kandidati i tretë me gjithsej 324 apo 64.8% të pikëve, rrjedhimisht Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*".

Përkitazi me pretendimin ankimor së Komisioni Përzgjedhës nuk ka qenë profesional, vendimi për themelimin e këtij Komisioni është në kundërshtim më nenin 7 paragrafi 1 dhe 5 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit të Shërbyesve Civil dhe së i njëjti nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe të ligjshëm të dokumentacionit të aplikimit lidhur me ankuesin, Kolegji nga administrimit i provave të lëndës respektivisht nga analizimi i Vendimit Nr.Ref.237/AMMK/2018 të datës 23.10.2018, ka gjetur së Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka qenë i themeluar në pajtim me dispozitat e nenit 7 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Institucionet themelojnë një Komision përzgjedhës ad hoc të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: KPSHC), i cili*

zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarë të cilët kanë pozita më të lartë se pozita që duhet të rekrutohet, po një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor, dhe se Kolegji nga analizimi i provave nuk ka hasur në ndonjë parregullsië përkitazi me vlerësimin e kandidateve nga ana e Komisionit përzgjedhës, andaj në këtë kuptim Kolegji konstaton se është i pa bazuar pretendimi ankimor si me lartë.

Nisur nga rrethanat dhe të gjeturat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën e punës "Zyrtar/e Administrativ", e shpallur sipas Konkursit me numër reference MMPH-22/2018 të datës 04.10.2018, është zhvilluar në pajtim me nenin 11 paragrafi 1 dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.KZKA-19/2018 të datës 17.12.2018 i kundërshtuar me ankesë, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.05/2019

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësueses me autorizim të ankuesit avokates
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

